



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201502033/8

Tiranë ___/___/2016

Lënda: *Rekomandohet marrja e nismës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj Rregjistruesit të Z.V.RR.P.P. Shkodër.*

Drejtuar : **Ylli Manjani**
Ministër i Drejtësisë

TIRANË

Për dijani: **Z.Illirjan Muho**
Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Rregjistrimit të
Pasurive të Paluajtshme

TIRANË

I nderuar Z.Ministër!

Institucioni i Avokatit në procesin e shqyrtimit të ankesës së shtetasit Arben Dajani, me banim në Fshatin Stajkë, Komuna Bushat, Shkodër, në të cilën prezantohet shqetësimi i mosdhënies së shërbimit të kërkuar konform aplikimit datë 19.05.2015, të kryer prej shtetasit A.D., ka kërkuar në mënyrë të përsëritur ZVRrPP, Shkodër, me anë të shkresave nr.K3/A78-3 Prot, datë 04.05.2016 dhe nr.K3/A78-5 Prot, datë 01.07.2016, informacion dhe shpjegime sikurse përcaktuar në to.

Edhe pse Ministra e Drejtësisë ka tërhequr vëmendjen ZVRrPP, Shkodër, me shkresën nr. A-400/1 Prot, datë 02.06.2016, Kryeregjistruesi i ZQRPP, me shkresat nr.4207/1 Prot, datë 14.06.2016 dhe Nr.4881/2 Prot, datë 10.08.2016, për përmbushjen e detyrimit ligjor në dhënien e informacionit dhe shpjegimeve të kërkuar prej Institucionit të Avokatit të Popullit, Regjistruesi i ZVRRPP, Shkodër, ende nuk ka mundur përmbushjen e detyrimit ligjor ndaj Institucionit që unë përfaqësoj.

Referuar parashikimeve të kryera në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, neni 19, i cili parashikon midis të tjerave se;

"... Avokati i Popullit ka të drejtë të caktoj një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme",

ka përcaktuar në shkresën nr.K3/A78-3 Prot, datë 04.05.2016, drejtuar Rregjistruesit të ZVRRPP, Shkodër, detyrimin e përmbushjes së kërkesës sa më parë të jetë e mundur.

Edhe pse është konsumuar afati për përfundimin e procedurës administrative, i cili sipas parashikimit të kryer në nenin 91/2, të ligjit nr.44/2015, ”Kodi i Procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, është 60 ditë, Rregjistruesi i ZVRRPP, Shkodër, nuk ka prezantuar ndonjë justifikim rreth vonesës në dhënien e përgjigjes për kërkesën nr.K3/A78-3 Prot, datë 04.05.2016, të Avokatit të Popullit.

Gjithashtu, sipas parashikimit të kryer në nenin 70 të ligjit nr.33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, afati i informimit të subjektit, i cili ka paraqitur kërkesë për informim, trajtohet prej zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme brenda 15 ditëve.

Përpos situatës së prezantuar, konstatohet se, Regjistruesi i ZVRRPP, Shkodër nuk ka përmbushur dhe nuk përmbush detyrimin ligjor në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Popullit, duke u bërë në këtë mënyrë penges për Institucionin që unë përfaqësoj, në ushtrimin e detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, në mënyrë sa më efçente dhe në një afat sa më të arsyeshëm

Mosrespektimi i detyrimit ligjor nga ana e subjektit përfaqësues të organit të lartpërmendura, për kthimin e përgjigjeve rreth kërkesave të dërguara, vjen ndesh me parimin e ligjshmërisë, transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe i efçencës, sikurse parashikuar në nenin 4, 5, 6, 10, 13, 15 dhe 18, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe të detyrueshme për zbatim në kuptim dhe zbatim të nenit 1 dhe 2 të këtij Kodi.

Kjo situatë e krijuar prej qëndrimit që mbahet prej Regjistruesit të ZVRRPP, Shkodër, gjithashtu nuk vjen në përputhje me parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 “Pë ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

Për arsyet e bëra të ditura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se, “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”,

REKOMANDOJMË

Marrjen e nismës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj Rregjistruesit të Z.V.RR.P.P. Shkodër.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit, konform parashikimit të kryer në nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Bashkëlidhur ju dërgojmë,

Kopje të shkresës nr. K3/A78-3 Prot, datë 04.05.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Regjistuesit të ZVRrPP, Shkodër.

Kopje të shkresës nr. K3/A78-5 Prot, datë 01.07.2016, të Avokatit të Popullit, drejtuar Regjistuesit të ZVRrPP, Shkodër.

Kopje të shkresës nr.A-400/I Prot, datë 02.06.2016, të Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar ZQRrPP, Tiranë dhe ZVRrPP, Shkodër.

Kopje të shkresës nr.4207/1 Prot, datë 14.06.2016, të ZQRrPP, Tiranë, drejtuar ZVRrPP, Shkodër.

Kopje të shkresës nr.4881/2 Prot, datë 10.08.2016, të ZQRrPP, Tiranë, drejtuar ZVRrPP, Shkodër.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Konceptoi dhe Daktilografoi

A.Gjoleka